



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

NJOFTIM PËR ANGAZHIMIN E KONSULENTIT TË JASHTËM

Radio Televizioni Shqiptar në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 33 datë 31.07.2026 për angazhimin e konsulentëve të jashtëm me qëllim ndjekjen e procesit të transformimit institucional, fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë për angazhimin si:

“Konsulent i Jashtëm Financiar” me kontratë shërbimi.

Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 11 Gusht 2026.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.

Aplikuesit të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
2. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
3. Portofol Bashkëpunimi

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Diplomë universitare: Nivel "Master i Shkencave" (ose ekuivalent) në Financë, Kontabilitet ose Ekonomik.
- Titull Profesional: Të jetë Auditues Ligjor ose Kontabilist i Miratuar, i licencuar nga organizatat profesionale përkatëse dhe i njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose të zotërojë certifikim ndërkombëtar të njëvlershëm (p.sh. ACCA, CPA).
- Gjuha e huaj: Njohje e mirë e gjuhës angleze të biznesit dhe financës
- Të jetë i regjistruar rregullisht: Duhet të zotërojë NIPT aktiv (si person fizik ose juridik) për të faturuar shërbimin dhe për të paguar detyrimet tatimore

1. Kualifikimi Edukativ dhe Certifikimet:

- Certifikime Profesionale: Zotërimi i titullit Auditues Ligjor ose Kontabilist i Miratuar, ose një certifikim ndërkombëtar profesional i barasvlershëm (p.sh. ACCA, CPA)

- Arsimi dhe Trajnimet e Avancuara: Trajnime mbi standartet e raportimit Financiar
- Përvoja e Përgjithshme: Mbi 7 vite përvojë në financë/auditim/kontabilitet.
- Përvojë specifike në legjislacion dhe standarde: Përvojë në standartet e kontabilitetit, legjislacionin financiar dhe raportimin financiar.

2. Dokumentacioni që duhet dorëzuar për Aplikim:

- CV e detajuar dhe letër motivimi ku shpjegohet përshtatshmëria me projektin.
- Kopje të diplomave, certifikatave dhe licencës (Audies Ligjor/Kontabilist I miratuar/ACCA/CPA).
- Oferta Ekonomike
- Deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.